



**REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO**

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT  
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE  
NATIONAL AUDIT OFFICE**

**Nr. i Dokumentit:24.34.9-2015-10**

**RAPORTI I AUDITIMIT PËRCJELLËS  
ZBATIMI I KONTRATËS PËR SISTEMIN E PROKURIMIT  
ELEKTRONIK**

**Prishtinë, Shkurt 2017**

Auditori i Përgjithshëm, i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative.

Zyra Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërdrejt llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve të tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditimet e performancës vlerësojnë nëse programet qeveritare menaxhohen në mënyrë të duhur, kost-efektive dhe efikase dhe nëse sistemet për matjen dhe raportimin e efikasitetit tyre janë funksionale.

Auditimet përcjellëse të performancës kryhen me qëllim që të vlerësohet se deri çfarë mase organizata e audituar ka arritur të zbatojë rekomandimet e nxjerra në raportin e auditimit.

Ky raport përcjellës vlerëson se deri në çfarë niveli, akterët përgjegjës për funksionimin e prokurimit elektronik kanë arritur të adresojnë rekomandimet e lëshuara në raportin e publikuar.

Ky raport përcjellës është kryer në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Vlorë Mehmeti dhe nën menaxhimin dhe udhëheqjen e Drejtorit të auditimit Mirlinda Ahmeti, mbështetur nga Fexhrie Thaqi dhe Elvin Mala (Anëtarë të ekipit).

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje ekzekutive.....	1
1 Hyrje.....	3
1.1 Metodologjia e punës audituese.....	3
2 Rekomandimet dhe niveli i adresimit të tyre.....	5
Rekomandimi 1 dhe niveli i zbatimit.....	6
Rekomandimi 2 dhe niveli i zbatimit.....	8
Rekomandimi 3 dhe niveli i zbatimit.....	10
Rekomandimi 4 dhe niveli i zbatimit.....	11
Rekomandimi 5 dhe niveli i zbatimit.....	12
Rekomandimi 6 dhe niveli i zbatimit.....	13
3 Konkluzion dhe rekomandim .....	14
Shtojca 1.....	15

---

## Lista e shkurtesave

ASHI	Agjencia e Shoqërisë së Informacionit
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
BB	Banka Botërore
COBIT	Objektivat Kontrolluese të TI-së
KRPP	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
MAP	Ministria e Administratës Publike
MF	Ministria e Financave
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit

---

## Përmbledhje ekzekutive

Prokurimi publik është aspekt kyç në administratën publike i ndërlidhur edhe me sistemin financiar publik, me rezultatet shoqërore dhe ekonomike, dhe si i tillë është një përcaktues kryesor i efektivitetit të qeverisë, dhe i cilësisë së shërbimeve publike dhe infrastrukturës. Një nga temat e rëndësishme të "Strategjisë për Qeverisje elektronike 2009-2015" të Republikës së Kosovës është që të vejë prokurimet në dispozicion dhe të jenë të arritshme për komunitetin ofertues dhe qytetarët e saj nëpërmjet zbatimit të prokurimit elektronik. Vendosja e prokurimit elektronik është parë si një hap kritik në procesin e modernizimit të prokurimit, i cili do të rrisë edhe më tej transparencën dhe do të përmirësojë efikasitetin e procesit. Qëllimi i projektit të prokurimit elektronik është që të krijojë një platformë të prokurimit, duke u bazuar në eksperiencën e suksesshme të praktikave më të mira evropiane në fushën e shërbimeve të prokurimit publik.

Në Kosovë, prokurimi elektronik vetëm se ka filluar se zbatuari dhe Zyra Kombëtare e Auditimit ka dhënë rekomandimet për zbatim në raportin e auditimit "Zbatimi i kontratës për sistemin e prokurimit elektronik"<sup>1</sup>, të publikuar edhe në faqen zyrtare të internetit të Zyrës Kombëtare e Auditimit.

Ky raport përcjellës i auditimit ka të bëjë me adresimin e rekomandimeve të dhëna nga Zyra Kombëtare e Auditimit për auditimin e sipër cekur.

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik ka përgatitur planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve dhe e ka dorëzuar atë në Zyrën Kombëtare të Auditimit brenda afateve kohore të parapara me kërkesat ligjore. Në atë plan, Komisioni Rregullativ Prokurimit Publik ka përcaktuar masat dhe personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve, por megjithatë nuk ka përcaktuar afatet kohore për zbatimin e tyre.

Ekipi i auditimit ka kryer vlerësimin se deri në çfarë niveli Ministria e Financave dhe Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik kanë arritur t'i zbatojnë rekomandimet e dhëna në raport. Sipas vlerësimit tonë, Ministria e Financave dhe Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik kanë ndërmarr disa veprime në drejtim të adresimit të çështjeve të dala nga raporti i auditimit të vitit 2016 porse mbetet ende punë për tu bërë.

Progres fillestar është arritur në fushën e efikasitetit në transferin e njohurive për të gjitha kategoritë e shfrytëzuesve. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik ka arritur që të identifikojë nevojat për disa fusha kur bëhet fjalë për qeverisjen adekuate të sistemeve të informacionit, sigurinë e mjaftueshme të sistemeve të informacionit, ndërveprimin me sistemet e jashtme informative, si dhe sigurimin adekuat të performancës së sistemit informativ. Megjithatë, nuk janë ndërmarrë hapa konkret për zbatimin e tyre në tërësi. Përderisa, rekomandimet të cilat i takojnë fushës për Organizimin Institucional mbeten ato më pak apo që nuk janë adresuar fare.

---

<sup>1</sup> [www.zka-rks.org/repository/docs/e-procurement\\_2015\\_Shqip\\_410300.pdf](http://www.zka-rks.org/repository/docs/e-procurement_2015_Shqip_410300.pdf)

Prej 13 (trembëdhjetë) rekomandimeve, 2 (dy) rekomandime janë adresuar dhe është vërejtur progres fillestar, për 9 (nëntë) rekomandime është identifikuar nevoja për adresim por nuk janë ndërmarrë hapa konkret, përderisa për 2 (dy) rekomandime nuk është ndërmarr asnjë hap për adresimin e tyre dhe nuk janë identifikuar nevojat për adresimin e tyre.

Me qëllim të funksionalizimit të sistemit të prokurimit elektronik dhe krijimin e parakushteve për kryerjen e prokurimeve në mënyrë elektronike, Ministria e Financave në bashkëpunim me Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik duhet t'i sigurojnë të gjitha burimet e nevojshme që me një intensitet të shtuar të fillohet me adresimin e plotë të rekomandimeve. Kjo duhet të ndodh brenda një kornize kohore paraprakisht të përcaktuar për të mundësuar punën efektive të sistemit elektronik të prokurimit.

### **Përgjigja e Ministrit të Financave dhe Kryetarit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik**

Ministri i Financave dhe Kryetari i Komisionit nuk kanë ofruar komente lidhur me të gjeturat dhe konkluzionet e auditimit. Ne inkurajojmë Ministrin dhe Kryetarin për adresimin e rekomandimeve të dhëna në këtë raport.

# 1 Hyrje

Në Korrik të vitit 2016, Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka publikuar raportin e auditimit me titull “Zbatimi i kontratës për sistemin e prokurimit elektronik”. Kontrata kishte një vlerë fillestare prej afër 580,000€ ofruar nga Banka Botërore në formë të grantit, mirëpo pas vazhdimëve dhe kërkesave shtesë kjo kontratë ka arritur shumën e përgjithshme prej rreth 650,500€.

Raporti ynë ka adresuar disa mundësi për të përmirësuar qasjen në mënyrën e zbatimit të kontratës për prokurimin elektronik nga ana e Ministrisë së Financave (MF) si dhe nga ana e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP) si institucione përgjegjëse për zbatimin e saj.

Bazuar në të dhënat e Raportit<sup>2</sup> vjetor të KRPP për vitin 2015 vlera e kontratave të nënshkruara ishte afër 402 milion €, përfshirë në këtë shumë edhe vlerat e aneks kontratave. Vlera e kontratave për vitin 2014 ishte 390 milion €.

Ky auditim përcjellës është iniciuar nga ZKA pas kërkesës së Kryetarit të KRPP për sigurimin e ekspertizës nga auditorët e ZKA në përmirësimin e mangësive në sistemin e prokurimit elektronik. Objektiva e ZKA është që përmes këtij raporti përcjellës t’i ofroj ndihmë KRPP dhe MF në përmirësimin dhe funksionalizimin sa më të shpejt të sistemit të prokurimit elektronik.

Ne kemi vlerësuar nëse subjekti i audituar ka adresuar rekomandimet e dhëna dhe nëse po deri në çfarë mase e ka bërë këtë. Vlerësimi i bërë ka rezultuar me përpilimin e këtij raporti përcjellës.

## 1.1 Metodologjia e punës audituese

Për të paraqitur ndryshimet dhe veprimet e ndërmarra ne kemi përdorur modelin e maturimit të përgjithshëm që shfaq statusin e mjedisit të kontrollit dhe vendosjen e kontrolleve në organizatë. Ky model i zhvilluar nga COBIT<sup>3</sup> paraqet se si menaxhimi i kontrollit të brendshëm dhe një ndërgjegjësimit i nevojës për kontrolle të tilla më të mira zhvillohen nga një nivel ad-hoc në një nivel të optimizuar. Duke përdorur këtë model do të paraqesim zhvillimet apo avancimet e bëra nga organizata në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të pasqyruara në raportin e ZKA për zbatimin e kontratës për sistemin e prokurimit elektronik.

---

<sup>2</sup> [krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/Raportet%20Vjetore/2016/Raporti%20vjetor%202015%20Shqip.pdf](http://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/Raportet%20Vjetore/2016/Raporti%20vjetor%202015%20Shqip.pdf)

<sup>3</sup> COBIT është një kornizë e praktikave të mira e krijuar nga shoqata ndërkombëtare profesionale ISACA për teknologjinë e informacionit (TI) menaxhim dhe qeverisje të TI. Për më shumë shih: [www.isaca.org/cobit](http://www.isaca.org/cobit)

Tabela në vijim paraqet nivelet e maturimit si dhe përshkrimin e shkurtër të kuptimit të tyre.

*Tabela 1- Niveli i Maturimit sipas kornizës COBIT*

Niveli i maturitetit		
0	Jo ekzistues	Mungesa e plotë e një procesi të njohur. Ndërmarrja nuk e ka pranuar edhe se ka një çështje që duhet adresuar.
1	Fillestar / ad-hoc	Ka dëshmi se ndërmarrja ka pranuar se çështjet ekzistojnë dhe duhet të adresohen. Megjithatë, nuk ka të standardizuar proceset; në vend të kësaj ka qasje të ad-hoc që tentojnë të aplikohen në baza individuale. Qasja e përgjithshme e menaxhimit është e ç'organizuar.
2	I përsëritshëm por intuitiv	Proceset janë zhvilluar në fazën ku procedura të ngjashme janë ndjekur nga njerëz të ndryshëm që marrin përsipër të njëjtën detyrë. Nuk ka asnjë trajnim formal ose komunikim të procedurave standarde, dhe përgjegjësia i lihet individit.
3	Proces i përcaktuar	Procedurat janë standardizuar dhe dokumentuar, dhe komunikuar përmes trajnimit. Ajo megjithatë, i lihet individit për të ndjekur këto procese, dhe nuk ka gjasa që devijimet të zbulohen. Procedurat vetë nuk janë të sofistikuara, por janë formalizime të praktikave ekzistuese.
4	I menaxhueshëm dhe i matur	Është e mundur për të respektuar monitorimin dhe matur procedurat dhe të marrë masa aty ku proceset duhet të mos jenë duke punuar në mënyrë efektive. Proceset janë në përmirësim të vazhdueshëm dhe të sigurojnë praktika më të mira. Automatizimi dhe mjete të tjera janë përdorur në një mënyrë të kufizuar ose të fragmentuar.
5	I optimizuar	Proceset janë rafinuar në një nivel më të mirë të praktikës, bazuar në rezultatet e përmirësimit të vazhdueshëm dhe modelimit të maturimit me ndërmarrjet e tjera. IT është përdorur në mënyrë të integruar për të automatizuar rrjedhën e punës, duke siguruar mjete për të përmirësuar cilësinë dhe efikasitetin, duke e bërë ndërmarrjen të shpejtë për tu përshtatur.

Po ashtu, gjatë këtij auditimi përcjellës kemi zhvilluar intervista me personat përgjegjës për funksionalizimin e sistemit të e-prokurimit për të mbledhur fakte dhe dëshmi. Është bërë edhe demonstrimi i sistemit gjatë të cilit janë testuar disa nga funksionet me rëndësi për të kryer këtë auditim përcjellës.



## 2 Rekomandimet dhe niveli i adresimit të tyre

Më tutje, do të paraqesim rekomandimet sipas raportit të publikuar<sup>4</sup> si dhe vlerësimin tonë për nivelin e zbatimit të tyre, duke përdorur nivelin e maturimit.

Tabela e mëposhtme paraqet një pamje të përgjithshme lidhur me atë se sa dhe deri në çfarë niveli janë adresuar rekomandimet duke vazhduar më tutje me vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve veç e veç.

*Tabela 2- Numri i rekomandimeve të zbatuara sipas niveleve të Maturimit*

Niveli i Maturimit		Gjithsej
0	Jo ekzistues	2 Rekomandime
1	Fillestar / ad-hoc	9 Rekomandime
2	I përsëritshëm por intuitiv	2 Rekomandime
3	Proces i përcaktuar	0 Rekomandime
4	I menaxhueshëm dhe i matur	0 Rekomandime
5	I optimizuar	0 Rekomandime

Nga tabela vërehet se numri më i madh i rekomandimeve është në nivelin fillestar/ad-hoc.

Në shtojcën 1 të këtij raporti është paraqitur niveli dhe krahasimi i zbatimit të rekomandimeve sipas maturimit në mënyrë figurative.

<sup>4</sup> [www.zka-rks.org/repository/docs/e-procurement\\_2015\\_Shqip\\_410300.pdf](http://www.zka-rks.org/repository/docs/e-procurement_2015_Shqip_410300.pdf)

## Rekomandimi 1 dhe niveli i zbatimit

E gjetura e përgjithshme: Organizimi institucional pjesërisht i zbatuar	
<b>Rekomandimi 1.1 :</b> Të krijohen mekanizma për të siguruar menaxhim dhe mbikëqyrje efektive të zbatimit të projektit	<b>Për:</b> Ministrinë e Financave
<b>Përshkrimi i rekomandimit:</b> Edhe pse zhvillimi dhe zbatimi i projektit është në fazën përfundimtare, duhet të krijohen mekanizmat, për të siguruar menaxhim dhe mbikëqyrje efektive gjatë fazës së zbatimit dhe pas zbatimit të projektit.	
<b>Vlerësimi i zbatimit:</b> Aktivitetet dhe funksionet e mekanizmave mbikëqyrës janë pothuajse jo aktive dhe ndërtimi i tyre është bërë në mënyrë të paqëndrueshme dhe duke mos konsideruar rekomandimet e dhëna për ndërtimin e tyre. Ekziston një mirëkuptim minimal mbi nevojën për organizimin e këtyre mekanizmave. Sidoqoftë, detyrat dhe përgjegjësitë nuk janë zyrtare apo zbatohen pjesërisht.	
<b>Niveli i maturimit:</b> 1 Fillestar / ad-hoc	
<b>Rekomandimi 1.2 :</b> Duhet të ekzistojë një proces i qartë i përgatitjes, menaxhimit dhe fuqizimit të ndryshimeve	<b>Për:</b> Kryetarin e Bordit të KRPP
<b>Përshkrimi i rekomandimit:</b> Procedurat e menaxhimit të ndryshimit duhet të paraqiten dhe të zbatohen në bazë të një procesi të përcaktuar dhe dokumentuar për të identifikuar dhe për të aplikuar përmirësimet teknologjike të nivelit të infrastrukturës dhe të aplikacionit. Kjo do të kodifikojë pritjet e përdoruesve të departamentit të Teknologjisë së Informacionit (TI), si dhe pranimin e ndryshimeve. Duhet të ekzistoj një proces i qartë i përgatitjes, menaxhimit dhe fuqizimit të ndryshimeve, e që do të përfshijë miratimin e menaxhmentit të lartë dhe angazhimin për ndryshime (përfshirë por jo të kufizuar edhe në harrime “patch” dhe përmirësime “update”).	
<b>Vlerësimi i zbatimit:</b> Nuk ka asnjë proces për menaxhimin e ndryshimeve të përcaktuara dhe ndryshimet mund të bëhen pa asnjë kontroll. Ndryshimet mund të jenë shkatërruese për operacionet e biznesit.	
<b>Niveli i maturimit:</b> 0 Jo ekzistues	

<p><b>Rekomandimi 1.3 :</b> Të krijohen mekanizma për të siguruar menaxhim dhe mbikëqyrje efektive të zbatimit të projektit</p>	<p><b>Rekomandimi për:</b> Kryetarin e Bordit të KRPP</p>
<p><b>Përshkrimi i rekomandimit:</b> Menaxhmenti i lartë duhet të miratojë skemën organizative si dhe rolet dhe përgjegjësitë e departamentit të TI në kuadër të KRPP. Përshkrimet e punës, Tabelat RACI dhe diagramet e matricës të rrjedhës së punës duhet tu sigurojnë 12 punonjësve një drejtim më të plotë dhe të qartë sa i përket roleve dhe përgjegjësi të tyre”, përfshirë por jo kufizuar në funksionet e administrimit të sistemit, administrimit të sigurisë, tavolinës së shërbimit (tavolinës ndihmëse), menaxhimit të mediave, administrimit të bazës së të dhënave, dhe zhvillimin e aplikacionit dhe mirëmbajtjes. Ndarja e detyrave duhet të zbatohet, kontrollohet dhe përcaktohet duke zbatuar autorizimin e transaksionit, ruajtjen e aseteve, qasjen në të dhëna dhe format e autorizimit.</p>	
<p><b>Vlerësimi i zbatimit:</b> Aktivitetet dhe funksionet e departamentit të TI janë pjesërisht aktive dhe zbatimi i tyre është bërë në mënyrë të paqëndrueshme. Nga ana e Menaxhmentit, ekziston një mirëkuptim minimal mbi nevojën për organizimin e TI. Sidoqoftë, detyrat dhe përgjegjësitë nuk janë zyrtarisht të zhvilluara dhe zbatuara dhe si të tilla nuk mund të zbatohen.</p>	
<p><b>Niveli i maturimit:</b> 1 Fillestar / ad-hoc</p>	
<p><b>Rekomandimi 1.4 :</b> Të krijohen mekanizma për të siguruar menaxhim dhe mbikëqyrje efektive të zbatimit të projektit</p>	<p><b>Për:</b> Kryetarin e Bordit të KRPP</p>
<p><b>Përshkrimi i rekomandimit:</b> Pronësia e Portalit dhe të dhënave të ndërlidhura duhet të merren përsipër nga KRPP për të siguruar qëndrueshmëri dhe për të parandaluar humbjen e të dhënave në lidhje me gabimet e raportuara nga përdoruesit.</p>	
<p><b>Vlerësimi i zbatimit:</b> Përgjegjësit kanë njohur nevojën për pronësinë e portalit dhe për zgjidhje të shkaqeve të lidhura me to. Individ me njohuritë kryesore ndihmojnë në probleme të lidhura me fushën e tyre të njohurive, por përgjegjësia e menaxhimit të problemeve nuk është përcaktuar.</p>	
<p><b>Niveli i maturimit:</b> 1 Fillestar / ad-hoc</p>	

## Rekomandimi 2 dhe niveli i zbatimit

E gjetura e përgjithshme: Qeverisje Joadekuate e Sistemeve të Informacionit

### Rekomandimi 2.1 :

Zhvillimi dhe zbatimit i politikave dhe procedurave

### Për:

Kryetarin e Bordit të KRPP

#### Përshkrimi i rekomandimit:

Në organizatë duhet të ekzistojnë politika dhe procedura të cilat do të mundësojnë mbikëqyrje efektive nga ana e menaxhmentit, krijimit të një ambienti pozitiv të kontrollit duke marrë përsipër përgjegjësinë për formulimin, zhvillimin, dokumentimin, shpalljen dhe kontrollimin e politikave që mbulojnë qëllimet dhe direktivat e përgjithshme. Për të arritur objektivat e politikës, procedura duhet të dokumentohet dhe hapat duhet të përcaktohen. Ato do të dokumentojnë proceset e biznesit dhe kontrollet e përfshira. Përveç kësaj, politikat dhe procedurat duhet aplikuar edhe për palët e treta, të cilët do të duhet të obligohen që ti ndjekin ato.

#### Vlerësimi i zbatimit:

Menaxhmenti i lartë nuk ka krijuar një mjedis të përshtatshëm për kontrollin e informacionit. Nuk është vërejtur identifikimi i nevojës për krijimin e një pakoje të politikave, procedurave, standardeve dhe proceseve të përputhshmërisë. Mbështetja e vetme bëhet tek politikat, procedurat, standardet dhe proceset e përputhshmërisë, të zhvilluara nga ASHI/MAP, të cilat nuk përmbushin nevojat e institucionit në tërësi.

#### Niveli i maturimit:

0 Jo ekzistues

### Rekomandimi 2.2 :

Menaxhimi i riskut

### Për:

Kryetarin e Bordit të KRPP

#### Përshkrimi i rekomandimit:

Procesi i menaxhimit të riskut gjithashtu duhet të jetë pjesë e politikave dhe procedurave të miratuara. Kjo duhet të sigurojë që KRPP është në gjendje të:

- Kuptojë dhe klasifikojë risqet që ndikojnë në prokurimin elektronik;
- Marrë vendime mirë të informuara në lidhje me shkallën e riskut;
- Përcaktojë shkallën e riskut dhe tolerancën e tij për sistemin e prokurimit elektronik; dhe
- Kuptojë se si të reagohet ndaj riskut në mënyrë të kontrolluar.

#### Vlerësimi i zbatimit:

Risqet e TI merren parasysh vetëm në baza ad hoc. Kryhen vlerësime jozyrtare të riskut që ndërliidhen me sistemin e prokurimit elektronik. Vlerësimet e risqeve shpesh herë përfshihen brenda planeve të projektit por rrallë herë u përcaktohen zyrtarët apo menaxheret përgjegjës. Risqet specifike lidhur me TI, si : siguria, gatishmëria dhe integriteti në raste të caktuara janë

përfshirë edhe në planin kryesor të projektit, si dhe raportet e progresit, të dokumentuara nga zbatuesi i kontratës. Kur risqet merren parasysh, zbutja e tyre është pa ndikim. Nuk ka një ndërgjegjësim mbi rëndësinë e risqeve lidhur me sistemin elektronik të prokurimit.

**Niveli i maturimit:**

1 Fillestar / ad-hoc

**Rekomandimi 2.3 :**

Zbatimi i Planit të Vazhdimësisë së Biznesit dhe atij të Rimëkëmbjes nga Katastrofa

**Për:**

Kryetarin e Bordit të KRPP

**Përshkrimi i rekomandimit:**

Duhet të zbatohet Plani i Vazhdimësisë së Biznesit dhe Plani i Rimëkëmbjes nga Katastrofat. Organizata duhet të zhvillojë këto dokumente fillimisht në bazë të një analize të ndikimit të biznesit. Planet dhe rezultatet e testimit duhet të miratohen nga Menaxhmenti i lartë, dhe shqyrtohen për ndryshime në bazë të rregullt (p.sh., rishikimi vjetor ose pas ndryshimeve të sistemit, infrastrukturës apo aplikacionit).

**Vlerësimi i zbatimit:**

Përgjegjësitë për shërbim të vazhdueshëm janë jo formale dhe autoriteti për zbatimin e përgjegjësiëve është i limituar apo i pazbatueshëm. Menaxhmenti i lartë është duke u ndërgjegjësuar për sa i përket riskut dhe nevojës për vazhdimësinë e shërbimit. Fokusi i vëmendjes së menaxhimit mbi vazhdimësinë e shërbimit, përqendrohet në burimet e infrastrukturës më shumë se në shërbimet e TI, kjo si pasojë e mos ndërtimit dhe aktivizimit të qendrës për rimëkëmbje dhe vazhdimësi të punës.

**Niveli i maturimit:**

1 Fillestar / ad-hoc

**Rekomandimi 2.4 :**

Tavolina mbështetëse/ndihmëse

**Për:**

Kryetarin e Bordit të KRPP

**Përshkrimi i rekomandimit:**

Tavolina mbështetëse/ndihmëse është përgjegjëse për t'u marrë me mbështetjen e përdoruesve të fundit, menaxhimin e incidentit dhe raportimit, ndërlidhjen me mbështetje teknike për ndryshimin e sistemit dhe korrigjimet si dhe funksionet e tjera që sigurojnë funksionim normal të sistemit.

**Vlerësimi i zbatimit:**

Ekziston një ndërgjegjësim i organizatës për sa i përket nevojës për tavolinë mbështetëse/ndihmëse si dhe për një proces të menaxhimit të incidenteve. Është e disponueshme përkrahja jo-formale nëpërmjet një rrjeti të njohurive individuale. Këta individë kanë filluar me zhvillimin dhe ndërtimin e mjeteve të përbashkëta të gatshme për të ndihmuar në zgjidhjen e incidenteve. Ende nuk ka trajnim zyrtar dhe komunikim të procedurave standarde, si dhe përgjegjësitë janë lënë në dorë të nismave individuale.

**Niveli i maturimit:** 2 I përsëritshëm por intuitiv

## Rekomandimi 3 dhe niveli i zbatimit

E gjetura e përgjithshme: Siguri e pamjaftueshme për Sisteme të Informacionit	
<b>Rekomandimi 3.1 :</b> Ndarja e roleve dhe përgjegjësi	<b>Për:</b> Ministrinë e Financave dhe Kryetarin e Bordit të KRPP
<b>Përshkrimi i rekomandimit:</b> Të gjitha përgjegjësitë e përcaktuara, të dokumentuara dhe llogaridhënia për grupet dhe individët përgjegjës për sigurinë e informacionit duhet të krijohen dhe të komunikohen me gjithë personelin dhe menaxhmentin përkatës.	
<b>Vlerësimi i zbatimit:</b> Funksioni i TI nuk është organizuar mjaftueshëm për tu përqëndruar në objektivat e organizatës. Është i organizuar të përgjigjet në baza individuale dhe ad hoc, por në mënyrë të paqëndrueshme ndaj nevojave të shfrytëzuesve të brendshëm dhe jashtëm. Nevoja për një strukturë të organizuar, definim dhe ndarje të roleve dhe përgjegjësi është një emergjencë që duhet vendosur. Po ashtu ekziston një emergjencë për teknika të përbashkëta për menaxhimin e organizimit të TI dhe shfrytëzuesve.	
<b>Niveli i maturimit:</b> 1 Fillestar / ad-hoc	
<b>Rekomandimi 3.2 :</b> Masat efektive të sigurisë	<b>Për:</b> Ministrinë e Financave dhe Kryetarin e Bordit të KRPP
<b>Përshkrimi i rekomandimit:</b> Për të siguruar menaxhimin e duhur të sigurisë së informacionit, duhet të përmbushen elementet e mëposhtme: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Duhet të krijohet korniza e politikave me një deklaratë koncize të Menaxhmentit të lartë për drejtimin, adresimin e vlerës së aseteve të informacionit, nevojën për siguri, dhe rëndësinë e përcaktimit të një hierarkie të klasave të aseteve të ndjeshme dhe kritike. Duhet të përfshijë si në vijim: standardet për të zhvilluar kritere dhe metoda paraprake matëse si bazë të sigurisë, praktika dhe procedura specifike;</li> <li>• Ndërgjegjësimi mbi sigurinë e informacioneve dhe nevojës për trajnime për të gjithë punonjësit e organizatës dhe aty ku përdoruesit e jashtëm përkatës duhet të marrin trajnim të duhur dhe përditësime të rregullta për të nxitur ndërgjegjësimin e sigurisë dhe pajtueshmërinë me politikat dhe procedurat e shkruara të sigurisë, dhe të futet në përdorim qasja dy-faktorëshe për përdoruesit të cilët qasen në sistem.</li> </ul>	
<b>Vlerësimi i zbatimit:</b> Organizata njihet nevojën për siguri të TI. Ndërgjegjësimi për nevojën për siguri varet fillimisht nga individët. Organizata nuk kryen matje të sigurisë së TI. Shkeljet e zbuluara të sigurisë së TI	

kërkojnë përgjigje ad hoc në rastet kur identifikohen, sepse përgjegjësitë janë të paqarta. Reagimet ndaj shkeljeve të sigurisë së TI janë të paparashikuara. Kjo vë re edhe si pasojë e mungesës së:

- Menaxhimit të sigurisë së TI;
- Planit të sigurisë së TI;
- Menaxhimit të identiteteve;
- Menaxhimit të llogarive të përdoruesve;
- Testimit, mbikëqyrjes dhe monitorimit të sigurisë;
- Përcaktimit të incidenteve të sigurisë;
- Mbrojtjes së sigurisë së teknologjisë;
- Menaxhimit të kodeve të kriptografisë;
- Parandalimit, detektimit dhe korrigjimit të Software-ve qëllim-keq;
- Sigurisë së rrjetit; dhe
- Shkëmbimit të të dhënave të ndjeshme.

**Niveli i maturimit:**

1 Fillestar / ad-hoc

## Rekomandimi 4 dhe niveli i zbatimit

**E gjetura e përgjithshme:** Ndërveprimi me sistemet e jashtme në nivel shumë të ulët

**Rekomandimi 4.1 :**

Ndërlidhja me sistemet e jashtme

**Për:**

Ministrinë e Financave dhe Kryetarin e Bordit të KRPP

**Përshkrimi i rekomandimit:**

Ndërlidhja e besuar me sistemin e Thesarit duhet të vendoset sa më shpejt që të jetë e mundur, për të verifikuar dhe përpunuar informacionin e kërkuar.

**Vlerësimi i zbatimit:**

Edhe pse organizata ka vlerësuar nevojën dhe rëndësinë e ndërlidhjes me sistemet e jashtme, si ajo me sistemet e ATK, Thesarit dhe MPB, është realizuar vetëm ajo me sistemin e ATK, përderisa për sistemet e tjera ende është e paqartë nevoja dhe mënyra e ndërlidhjes dhe funksionet që do të ofrohen me anë të këtyre ndërlidhjeve.

**Niveli i maturimit:**

1 Fillestar / ad-hoc

## Rekomandimi 5 dhe niveli i zbatimit

E gjetura e përgjithshme: Jo efikasitet në transferin e njohurive

### Rekomandimi 5.1 :

Planifikimi dhe ekzekutimi i trajnimeve për ngritje të kapaciteteve

### Për:

Kryetarin e Bordit të KRPP

### Përshkrimi i rekomandimit:

Të zhvillojë një plan të detajuar dhe me prioritet të trajnimit për grupin e përdoruesve dhe të zbatohet brenda një afati të dakorduar kohor për të siguruar që përdoruesit janë të trajnuar dhe certifikuar për përdorim efektiv të sistemit.

### Vlerësimi i zbatimit:

Ka ndërgjegjësim brenda organizatës rreth nevojës për programe trajnimi dhe edukimi si dhe për procese të lidhura me to. Trajnimi është identifikuar në planet e zbatimit të projektit, mirëpo si i tillë nuk është duke u zbatuar në masë të duhur, në veçanti për shfrytëzuesit e jashtëm. Po ashtu mungon identifikimi i nevojave apo parakushteve për trajnim, vlerësim të performancës si dhe vlerësim të trajnimeve.

### Niveli i maturimit:

2 I përsëritshëm por intuitiv



## Rekomandimi 6 dhe niveli i zbatimit

E gjetura e përgjithshme: Sigurimi joadekuat i performancës së sistemit

**Rekomandimi 6.1 :**

Pranimet Operative

**Për:**

Kryetarin e Bordit të KRPP

**Përshkrimi i rekomandimit:**

Të gjitha pranimet operative të specifikuara në planin e projektit duhet të zbatohen dhe rezultatet të dokumentohen në një periudhë kohore të përcaktuar qartë. Kriteret e pranimet duhet të përcaktohen për institucionet e pilotuara me qëllim që të vërtetohet funksionimi i duhur i sistemit. Testimet e pranimet të përdoruesve duhet të kryhen plotësisht dhe të dokumentohen para pranimet të sistemit dhe ngritjes së tij në ambientet e punës.

**Vlerësimi i zbatimit:**

Nuk ka vetëdijesim se çështjet e qeverisjes së TI ekzistojnë dhe duhet të adresohen. Ka qasje ad hoc që zbatohen në baza individuale ose rast pas rasti. Qasja e drejtimit është reaktive dhe sporadike, ka komunikim në kundërshtim me çështjet dhe qasjet për ti adresuar ato. Menaxhimi ka vetëm një tregues të përafërt nëse TI ka realizuar apo jo pranimet e ndryshme të funksionalitetit të sistemit, mirëpo jo edhe informatat e duhura rreth përputhshmërisë së tij, rezultatet e testimit si dhe rekomandimet dhe hapat që duhet të ndërmerren për evidentimin apo përmirësimin e tyre.

**Niveli i Maturimit:**

1 Fillestar / ad-hoc

### 3 Konkluzion dhe rekomandim

MF dhe KRPP kanë bërë disa veprime në drejtim të adresimit të çështjeve të dala nga raporti dhe rekomandimeve të dhëna në vitin 2015. Prej 13 (trembëdhjetë) rekomandimeve, 2 (dy) rekomandime janë adresuar dhe është vërejtur progres fillestar, për 9 (nëntë) rekomandime është identifikuar nevoja për adresim por nuk janë ndërmarrë hapa konkret, përderisa për 2 (dy) rekomandime nuk është ndërmarr asnjë hap për adresimin e tyre.

Rekomandojmë MF dhe KRPP që të ndërmarrin veprimet e nevojshme lidhur me zbatimin e plotë të rekomandimeve të pa adresuara dhe pjesërisht të adresuara duke përcaktuar afatet kohore dhe resurset e nevojshme për zbatimin e plotë të tyre për të mundësuar punën efektive të sistemit elektronik të prokurimit.

Plani i veprimit për implementimin e rekomandimeve duhet përditësuar, duke përfshirë edhe afatet kohore dhe resurset e nevojshme për zbatimin e tyre.

## Shtojca 1

Në grafikun në vazhdim, janë paraqitur rekomandimet si dhe niveli i zbatimit të tyre, duke shfrytëzuar nivelin i maturimit sipas kornizës COBIT.




Figura 1 - Niveli i zbatimit të rekomandimeve sipas nivelit të Maturimit